

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.26/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm– Gjyqtari i vetëm gjykues Gëzim Ademi, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri, në çështjen penale kundër të pandehurit H.B nga ... me vendbanim në rr. ...”, për shkak të veprës penale: Shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25 lidhur e nenin 18 par.1 pika 1,2 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP-II.nr.3372/2018 të datës 04.01.2019, në mungesë të PTH Natasha Radoviq, në prezencë të të pandehurit me datën 21.02.2019 ka shpallur publikisht, ndërsa me 12.03.2019 ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: H.B, nga i ati Z., e ëma M., e gjinisë U., i lindur me ..., me numër personal ..., me vendbanim në ..., rruga “ ...”, shqiptar, kosovar, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ndaj të pandehurit nuk zhvillohet procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Me datën 27.08.2018 rreth orës 07:00 në ..., në shtëpinë e babait e të dëmtuarës F.B ka shkelur Urdhrin mbrojtës i cili iu është shqiptuar nga ana e Gjykatës Themelore Mitrovicë C.nr. ... nga data 29.06.2018, ku është miratuar Kërkesa e palës së mbrojtur për ndalimin e shqetësimit dhe mbajtjen e distancës prej 50m., ashtu që edhe përkundër ndalesës në fjale në ditën kritike ka shkuar në shtëpinë e babait e të dëmtuarës për të biseduar dhe kërkuar që gruaja t’i kthehet sepse ishin të ndare që tre muaj, duke krijuar kështu frikë dhe shqetësim shtese të e dëmtuara.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25 lidhur me nenin 18 par.1 pika 1.2 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje**

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 7,8,9,10,21,50,51,73, dhe 25 lidhur me nenin 18 par.1 pika 1.2 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, e lidhur me nenin 365, 450 dhe 463 të KPP-ës i:

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatjeje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në kohëzgjatjeje prej 1 (një) viti.

OBLIGOHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro, ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të cilat shpenzime i pandehuri është i obliguar që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike -kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore ne Mitrovice ka ngritur aktakuze PP-II.nr.3372/2018 te datës 04.01.2019 kundër te pandehurit H.B, për shkak te veprës penale: Shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25lidhur e nenin 18 par.1 pika 1,2 te Ligjit për mbrojtje nga dhuna ne familje.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 21.02.2019 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e pranoj fajësinë, me vjen keq për rastin qe ka ndodhur dhe i njëjti i premtion gjykatës se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra penale, se me te njëjtën kam raporte te mira bashkëshortore se ne jemi bashkuar te njëjtën dite atë dite me është ndaluar nga vendimi nga e drejta civile qe mos ti ofrohem te dëmtuarës.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurorja i ka propozuar gjykatës qe ta bej pranimin e fajësisë dhe kjo te jete rrethane lehtësuese, ne rast te caktimit te dënimit, duke pasur fakte se te njëjtin janë pajtuar, jetojnë se bashku te gjitha këto te merren si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i te pandehurit Av. G.R lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: i propozon gjykatës qe ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit sepse vërtetohet edhe ne baze te provave qe i kemi ne lënd dhe se pranimi është bere ne baza vullnetare, pa presion apo ndikim nga jashtë. Është fakt i pa kontestueshëm se i akuzuari tani jeton bashke me bashkëshorten e tij kane raporte te mira, bashkëshortore, kalojnë një jete ne harmoni ne mes veti. Është për to keq se keqësimi i ma parshem i raporteve bashkëshortore ka ardh si pasoj e një sëmundje mentale te cilin fakt e argumentojmë me një raport mjekësor te lëshuar nga Dr. F.A. neupsikiater, shqiptimi i çfarëdo dënimi efektiv ne këtë rast penal do te ishte i pa efekt nga se as njeri prej dy bashkëshortëve nuk janë ne mardhënje pune. Mbrojtja mendon se dhe një dënim te kushtëzuar do te arrihet qëllimi i plot i dënimit.

E dëmtuara F.B lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: i propozon gjykatës qe ta bej pranimin e fajësisë ndaj te pandehurit pasi qe te dy jetojmë se bashku, kemi tre fëmijë te përbashkët, dhe raportet mes ne janë shume te mira, me pare nuk kemi pas raporte te këqija por vetëm ky rast ka ndodhur pas 20 vite martës, dhe njëherit i propozon gjykatës qe ta liroj.

II. Vlerësimi i pranimit te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Raporti policor nga Policia e Mitrovices-jug nga dt. 27.08.2018, Urdherin mbrojtës C.nr. ... nga data 29.06.2018, Aktvendimin mbi ndalimin e personit te arrestuar nga dt. 27.08.2018

Aktvendimin mbi ndërprerjen e ndalimit policor nga data 28.08.2018, dhe ekstraktin nga dosja kriminale per te pandehurin nga data 08.2018, nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25lidhur e nenin 18 par.1 pika 1,2 te Ligjit për mbrojtje nga dhuna ne familje.

III. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh dispozitën ligjore nenin 73 te KPRK-se, ashtu qe duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, raportet familjare me te dëmtuarën, ku te njëjtit kishin raporte te mira ne mes veti, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë rezulton se i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimeve, do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

IV. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që te pandehurin ta detyroj qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 30 Euro, ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te kriminimit shumen prej 30 euro, sipas taksa për kompensimin viktimave të kriminimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 per Kompensimin e Viktimave të Kriminimit, te cilat shpenzime i pandehuri është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

V. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridik-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.26/2019 dt.12.03.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të ankesë në afat prej 15 ditëve në gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate